



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:190803

Datë: 18.10.2024

Numri i dokumentit: 06371634

CA.nr.11291/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevcu – kryetar i kolegjit, Nora Bllaca - Dula dhe Hysni Bardheci - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore sipas propozimit të paditësve - propozuesve për masë të sigurisë B. Zh. nga fshati M., Komuna e V., B. K. nga P., Rruga “Z. Sh.” .., Nr., dhe D.K., nga Komuna në V., Rruga “S. V.i”, Nr., të cilët më autorizim i përfaqëson A. L., avokat në P., kundër të paditurës - kundërshtarit të sigurimit Ministria e Drejtësisë, Instituti i Mjekësisë Ligjor në Prishtinë, të cilën e përfaqëson N.A . avokate nga Avokatura Shtetërore, në Prishtinë, duke vendosur sipas ankesës së paditësve - propozuesve të masës së sigurimit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, C.nr.10030/2024 të datës 30.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditësve - propozuesve për masë të sigurisë, B.Zh.nga fshati M., Komuna e V., B. K. nga P., Rruga “Z. Sh.” .., Nr., dhe D. K., nga Komuna në V., Rruga “S. V.”, Nr., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, C.nr.10030/2024 të datës 30.07.2024, VERTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar C.nr.10030/2024 të datës 30.07.2024, ka vendosur si vijim: “REFUZOHET në tërësi propozimi i propozuesve të masës së sigurimit B.Zh., B. K. dhe D. K., me të cilën kanë kërkuar që t'i ndalohej kundërshtarit të sigurimit Ministrisë së Drejtësisë, Institutit të Mjekësisë Ligjore, që të bëjë korrigjimin dhe ndryshimin e pagës bazë sipas klasës së tetë me koeficient 12 që janë duke e realizuar propozuesit, sipas ligjit për pagat në sektorin publik dhe vendimit me nr. 04/128 të dt. 16.02.2023, përkatësisht të koeficientit H-669, të cekur në shtojcë të këtij vendimi si përshkrim i gradës së vjetër që është ekuivalent me

koeficientin e lartcekur të ligjit të ri, që është klasës H8 me koeficientet 12, me qëllim të ruajtjes së gjendjes ekzistuese dhe atë derisa vendimi i kësaj gjykatë për çështje meritore të bëhet i plotfuqishëm apo deri në vendimin e ri të marrë nga kjo gjykatë, si i pabazuar”.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor paditësit - propozuesit e masës së sigurimit, përmes të autorizuarit të tyre kanë paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, me propozimin që Gjykata e Apelit, ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe ta ndryshoj aktvendimin e atakuar C.nr.10030/2024 të datës 30.07.2024, ashtu që ta caktojë masën e sigurimit të propozuar, apo ta anulojë aktvendimin e atakuar dhe lëndën ta kthej në shkallë të parë për rivendosje.

Kundërshtari i sigurimit, nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e paditësve - propozuesve të masës së sigurimit, është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit - propozuesit e masës së sigurimit, përmes të autorizuarit të tyre, me datën 05.07.2024, në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur propozimin për masë të sigurisë, ndërsa me datën 30.07.2024, e kanë paraqitur padinë, kundër të paditurës, më propozimin që të caktohet masa e sigurisë dhe t'i ndalohet kundërshtarit të sigurimit, që të bëjë korrigjimin dhe ndryshimin e pagës bazë, sipas klasës së tetë me koeficient 12 që janë duke e realizuar propozuesit, sipas ligjit për pagat në sektorin publik dhe vendimit me nr. 04/128 të dt. 16.02.2023, përkatësisht të koeficientit H-669, të cekur në shtojcë të këtij vendimi si përshkrim i gradës së vjetër që është ekuivalent me koeficientin e lartcekur të ligjit të ri, që është klasës H8 me koeficientet 12, me qëllim të ruajtjes së gjendjes ekzistuese.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas propozimit për caktimin e masës së sigurimit, dhe pas analizimit të tërësishëm të provave, me aktvendimin C.nr.10030/2024 të datës 30.07.2024, e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurimit, duke vendosur më decidivisht si në aktvendimin e ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka theksuar se duke vepruar sipas propozimit për caktimin e masës, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore dhe ka konstatuar se propozuesi i sigurimit nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive, si dhe ekzistimin e rrezikut për realizimin e kërkesës, ashtu siç parashihet me dispozitën e nenit 297 dhe dispozitës së nenit 304 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të propozueses për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, e as shkeljeve të tjera nga neni 182.2 të LPK-së, pasi që arsyetimi i aktvendimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, par. 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktvendimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën.

Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, sipas dispozitës së nenit 297, paragrafi 1 pika a) dhe b) dhe 297 paragrafi 2 të LPK, përcaktohet në mënyrë të qartë se *“masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se plotësohen në mënyrë kumulative tri kushte dhe atë: besueshmëria ekzistimit të kërkesës apo të së drejtës subjektive, ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës dhe deponimi i garancionit”*. Në çdo rast kur nuk plotësohet ndonjëri nga kushtet e sipër theksuara atëherë gjykata nuk mund të vendosë për aprovimin e kërkesës për sigurimin e kërkesëpadisë. Në këtë rast Gjykata e Apelit e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurimit, për shkak se paditësit–propozuesit e masës së sigurimit për momentin nuk e ka bërë të besueshme rrezikun se pa caktimin e masës së sigurimit do të pamundësohet apo vështirësohet realizimi i kërkesave të tyre.

Në rastin konkret Gjykata e Apelit, e pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për mos caktimin e masës së sigurimit, për shkak se gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme përfundimin e saj për refuzimin e caktimit të masës së sigurimit. Kjo për faktin se ka rezultuar se propozuesit e sigurimit nuk e ka argumentuar mjaftueshëm se pa caktimin e masës paditësit nuk do të mund të realizonte të drejtën e tyre në të ardhmen nëse vërtetohet me vendim të formës së prerë. Gjykata e Apelit vlerëson se në kontekstin e rrethanave të paraqitura në këtë çështje juridike kontestuese e që i referohen pretendimeve të paditësve – propozuesve të sigurimit lidhur me ekzistimin e të drejtës subjektive dhe rrezikun e mundshëm që propozuesve të ju vështirësohet apo pamundësohet realizimi i të drejtave të tyre, pa e predikuar përfundimin

meritor të kësaj çështje, në këtë fazë të procedurës konsiderohet i drejtë qëndrimi juridik e gjykatës së shkallës së parë, se caktimi i masës së sigurisë në këtë fazë të procedurës nuk është i arsyeshëm dhe i bazuar.

Gjykata e Apelit, vlerëson se masa e sigurimit të kërkesëpadisë ka për qëllim të evitohet rrezikun për realizimin e të drejtave subjektive të palëve ndërgjyqëse (propozueseve në këtë rast), po ashtu edhe të personave të tretë që mund të involvohen nëse nuk caktohet një masë e tillë. Gjykata e Apelit vlerëson se refuzimin e masës së sigurimit nga gjykata e shkallës së parë, dhe vërtetimi përmes këtij Aktvendimi, të një vendimi të tillë, nuk e prejudikon zgjidhjen e kontestit ndërmjet palëve ndërgjyqëse.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të paraqitura në ankesë, por ka gjetur se janë të pa bazuara dhe se nuk ndikojnë që gjykata të marrë një vendim ndryshe. Por, në rastin konkret gjykata ankimore ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paraqitura me ankesë për shkak se gjykata e shkallës së parë përfundimin e saj e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme sa i përket rrethanave që kanë ndikuar për refuzimin e kërkesës për caktimin e masës së sigurisë.

Përfundimisht, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 194, 208 dhe nenin 209 pika (d) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.11291/2024 datë 17.10.2024

Kryetar i kolegjit - gjyqtari
Adnan Konushevcu d.v.